



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



LISTA E VENDIMEVE TE MARRURA NGA KRYETARI I KOMUNËS SË RAHOVECIT, Z. SMAJL LATIFI

NGA DATA 28 DERI 31 GUSHT 2023

Nr	Emri i vendimit	Nr. Protokollit
1	Vendim për ndërprerjen e kontratës me marrëveshje të dyanshme, me titull "Lot 1- Ndërtimi i hapësirave rekreative për të rinj"	NRP-02-2055-2023
2	Vendim	NRP-02-2056-2023
3	Vendim për caktimin e komisionit për mbikëqyrjen e zbatimit të strategjisë së zhvillimit ekonomik lokal për Komunën e Rahovecit	NRP-02-2058-2023
4	Vendim-shfuqizohet vendimi i Komisionit të pranimit të Komunës së Rahovecit	NRP-02-2059-2023
5	Vendim për caktimin e jursë profesionale për vlerësimin e punimeve të busteve të dëshmorëve: Sadedin Hajda, Gëzim Hamza-Piktori dhe Mizair Isma	NRP-02-2060-2023
6	Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit me nr.prot. 02/2033/23, i dates 23.8.23, për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave	NRP-02-2061-2023
7	Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit me nr.prot. 02/1086/23, i dates 9.8.23, për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave	NRP-02-2062-2023
8	Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit me nr.prot. 02/2031/23, i dates 22.8.23, për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave	NRP-02-2063-2023
9	Vendim miratohet kërkesa e z. [REDACTED]	NRP-02-2064-2023
10	Vendim miratohet [REDACTED]	NRP-02-2065-2023
11	Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës	NRP-02-2070-2023

31.8.2023, Rahovec

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRESIEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR'S CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2072 Nr. i faq./Br.str./No.pg 9
Data/Datum/Date 1/9/23
RAHOVEC / ORAHOVAC



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVËS, REPUBLIKA KOSOVOV, REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC, OPŠTINA ORAHOVAC, MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI I KRYEVAJTES, KOMUNZGAJINET, PREDSIEDNIA OPŠTINE, MUNICIPAL MAYOR, RAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br. No 2055 Nr i faq/Br str No pg 8
Data/Datum/Date 28/8/23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, nenit 72 të Rregullores Nr. 001/2022 për prokurimin publik me Nr. Prot. 82/2022 të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe 92. paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës Rahovec, Nr. 1005. i datës 29.03.2017, rekomandimit të Menaxherit të Projektit dhe Mbikëqyrësit të Drejtëpërdrejtë me Nr. Prot. 13, Nr. 69 të datës 25.08.2023 për ndërprerjen e kontratës me titull: "Lot 1 - Ndërtimi i hapësirave rekreative për të rinj", me numër të kontratës: 623-21-4146-5-1-1/C323, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për ndërprerjen e kontratës me marrëveshje të dyanshme, me titull "Lot 1 - Ndërtimi i hapësirave rekreative për të rinj"

1. Miratohet kërkesa e menaxherit të projektit dhe e mbikëqyrësit të drejtëpërdrejtë për ndërprerjen e kontratës me marrëveshje të dyanshme, me titull "Ndërtimi i hapësirave rekreative për të rinj", me numër të kontratës: 623-21-4146-5-1-1/C323.
2. Ndërprerja e kontratës me marrëveshje të dyanshme, sipas pikës 1 të këtij vendimi, bëhet për shkak të ngjarjes së shkaktuar nga forca mëdhe, që është shkaktuar pas datës kur kontrata ka hyrë në fuqi.
3. Obligohet Zyra e Prokurimit që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme konform dispozitave ligjore në fuqi për ndërprerjen e kontratës, sipas pikës 1 të këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Pas zhvillimit të të gjitha procedurave të prokurimit, Komuna e Rahovecit (në vazhdim Autoriteti Kontraktues), ka nënshkruar Kontratë publike kornizë me Grupin e Operatorëve Ekonomik Agim Trolli B.L., Visar Kuqi B.L. (në vazhdim Furnizuesi), me titull "Lot 1 - Ndërtimi i hapësirave rekreative për të rinj", me numër të kontratës: 623-21-4146-5-1-1/C323 me Nr. Prot. 4869 të datës 25.10.2021.

Pas nënshkrimit të kontratës, Autoriteti kontraktues ka kryer punët sipas kushteve të parapara në kontratë.

Mirëpo, pas paraqitjes së Pandemisë COVID-19, situata ka ndryshuar, sepse artikujt të cilët janë objekt i punimeve, sipas kësaj kontrate, kanë pësuar ndryshime të mëdha në çmimin e furnizimit.

Për këtë arsye, Grupi i Operatorëve Ekonomik Agim Trolli B.I., Visar Kuqi B.I., ka parashtruar kërkesë të menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me Nr. Prot. 5201 të datës 24.08.2023, të cilët janë caktuar me vendim të Zyrtarit Kryesor Administrativ, ndërprerjen e kontratës me titull: "Lot 1 - Ndërtimi i hapësirave rekreative për të rinj", me numër të kontratës: 623-21-4146-5-1-1/C323, me arsyetimin se çmimet e produkteve nga momenti i nënshkrimit të kontratës në vitin 2021, kanë pësuar rritje të mëdha në vitin 2022, dhe me këtë rast është e pamundur kryerja e punimeve sipas kontratës.

Pas kësaj, Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, u janë drejtuar Kryetarit të Komunës me kërkesë me Nr. Prot. 13 Nr. 69 të datës 25.08.2023 për ndërprerjen e kontratës me titull: "Lot 1 - Ndërtimi i hapësirave rekreative për të rinj", me numër të kontratës: 623-21-4146-5-1-1/C323, sipas kërkesës së arsyetuar të operatorit ekonomik.

Për këtë arsye, pas kërkesës së pranuar të Grupit të Operatorëve Ekonomik Agim Trolli B.I., Visar Kuqi B.I., me Nr. Prot. 5201 të datës 24.08.2023, si dhe rekomandimit të menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të kontratës për ndërprerjen e kontratës me titull: "Lot 1 - Ndërtimi i hapësirave rekreative për të rinj", me numër të kontratës: 623-21-4146-5-1-1/C323, për shkak të rritjes së vazhdueshme të çmimeve të produkteve bazë për ndërtim në bursa ndërkombëtare, po ashtu edhe në Republikën e Kosovës, pas paraqitjes së Pandemisë COVID-19, si dhe duke u bazuar në nenin 38 të kësaj kontrate, në të është e paraparë "forca majdhore", e cila është shkaktuar pas datës kur kontrata ka hyrë në fuqi.

Pas administrimit të të gjitha provave, Kryetari i Komunës ka konstatuar se janë përdorur të gjitha kushtet ligjore për ndërprerjen e kontratës me Nr. Prot. 4869 të datës 25.10.2021, me titull: "Lot 1 - Ndërtimi i hapësirave rekreative për të rinj", me numër të kontratës: 623-21-4146-5-1-1/C323.

Nga se u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Me vendim të njoftohen:

- Zyra e Prokurimi,
- Menaxheri i Projektit,
- Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të projektit, dhe
- Arkivi.

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna Rahovec

Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), në nenin 34 të Ligjit Nr. 06L-114 për Zyrtarët Publikë, nenit 17 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 92 të Statutit të Komunës, kryetari i Komunës Rahovec, merr këtë:

V E N D I M

1. Formohet Komisioni i Rekrutimit për të zhvilluar procedurën Ngritje në detyrë - avancim, në Konkursin RN00012201, për pozitën: Udhëheqës i sektorit për Shërbime Sociale, në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, në këtë përbërje:

- 1.Ylfete Kryeziu, kryesuese,
 - 1.1. Hyrmete Hajda, zëvendësuese,
2. Isak Hoti, anëtar,
 - 2.1. Ardian Rama, zëvendësues,
3. Kapllan Gashi, anëtar,
 - 3.1. Esat Hoti, zëvendësues.

2. Detyrat e komisionit janë të përcaktuara me Ligjin Nr. 06L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset komisioni.

4. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- Komisioni,
- Udhëheqësi i Personelit, dhe
- Arkivi.

Sprajl Latifi
Kryetar i Komunës

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO
RAHOVEC / ORAHOVAC
MUNICIPALITY / OPŠTINA
KRYETARI I KOMUNES / PRESEDNIK OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR
KABINET

Nr. i fletës / No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr. / Br. / No 2056 Nr. i faq / Br. str. / No. pg 8
Data / Datum / Date 28.18.23
RAHOVEC / ORAHOVAC



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna Rahovec

Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr. 03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës Rahovec, Nr. 1005, i datës 29.3.2017 dhe Strategjisë së zhvillimit ekonomik lokal për Komunën Rahovec 2021-2025, kryetari i Komunës Rahovec, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për mbikëqyrjen e zbatimit të Strategjisë së zhvillimit ekonomik lokal për Komunën Rahovec 2021-2025

1. Caktohet komisioni për mbikëqyrjen e zbatimit të Strategjisë së zhvillimit ekonomik lokal për Komunën Rahovec 2021-2025, në këtë përbërje:
 - 1.1. Fidan Hoti, kryesues,
 - 1.2. Egzon Thaqi, anëtar,
 - 1.3. Sylejman Daka, anëtar.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit janë të përcaktuara në Strategjinë e zhvillimit ekonomik lokal për Komunën Rahovec 2021-2025, me Nr. Prot. 01 Nr. 213/21, të datës 29.6.2021.
3. Obligohet komisioni i lartpërmendur që të hartojë raport me shkrim në baza 6 (gjashtë) - mujore për kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm mbi ecurinë e zbatimit të Strategjisë së zhvillimit ekonomik lokal për Komunën Rahovec 2021-2025.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Të lartpërmendurve,
- Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, dhe
- Arkivit.

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRESEDINA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR'S CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 208 Nr. i faq./Br.str./No.pg 8
Data/Datum/Date 24/ 8/ 23
RAHOVEC / ORAHOVAC





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna Rahovec
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 2 të Statutit të Komunës Rahovec, Nr. 1005, i datës 29.3.2017 dhe Vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Nr. Prot.: 5703/2023, i datës 17.8.2023, kryetari i Komunës Rahovec, merr këtë:

V E N D I M

1. Me këtë vendim **shfuqizohet** vendimi i Komisionit të Pranimit të Komunës Rahovec, me Nr. Prot. 862, i datës 27.06.2023.
2. **Anulohet** konkursi me Nr. Reference: RN00011575 për emrin e grupit "*Specialist i Arsimit*" për pozitën: Zyrtar i Arsimit të Mesëm të Lartë, të shpallur më datë: 2.5.2023 nga Njësia e Personelit dhe të gjitha veprimet që rrjedhin nga kjo procedurë.
3. **Obligohet** Njësia e Personelit në Komunën Rahovec, që të bëjë rishpalljen e konkursit, sipas afateve ligjore.
4. Për zbatimin e këtij vendimi, do të kujdeset Njësia e Personelit, Drejtoria për Arsim dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën Rahovec.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 17.8.2023, ka marrë vendim me Nr. Prot. 5703/2023, me të cilën ka aprovuar si të bazuar ankesën e parashtruar nga ankuesi Gani Kryeziu, në konkursin me Nr. Reference RN00011575, për emrin e grupit "*Specialist i Arsimit*" për pozitën: Zyrtar i Arsimit të Mesëm të Lartë, të shpallur më datë 2.5.2023 nga Njësia e Personelit.

Pas administrimit të të gjitha provave dhe fakteve në shkresat e lëndës, si dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Nr. Prot. 5703/2023, i datës 17.8.2023, shfuqizohet vendimi i Komisionit të Pranimit të Komunës Rahovec, me Nr. Prot. 862, i datës 27.6.2023 si dhe Anulohet konkursi me Nr. Reference: RN00011575 për emrin e grupit "*Specialist i Arsimit*", për pozitën: Zyrtar i Arsimit të Mesëm të Lartë, të shpallur më datë: 2.5.2023 nga Njësia e Personelit dhe të gjitha veprimet që rrjedhin nga kjo procedurë.

Andaj, nga se u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- **KPMSHCK-së,**
- **Drejtorisë për Arsim,**
- **Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,**
- **Njesisë së Personelit, dhe**
- **Arkivit.**

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC	
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRESEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET	
Njësia Nr./Br./No <u>02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)</u>	
Nr./Br./No <u>2059</u> Nr i faq/Br.str/No.pg <u>8</u>	
Data/Datum/Date <u>29.8.23</u>	
RAHOVEC / ORAHOVAC	

Smajl Latifi

Kryetar i Komunës

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) dhe nenit 74 dhe 92 paragrafit 1 dhe 4 të Statutit të Komunës Rahovec, me Nr.1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

**Për caktimin e jurisë profesionale për vlersimin e punimeve të busteve të dëshmorëve:
Sadedin Hajda, Gëzim Hamza – Piktori dhe Mizair Isma**

1. Më këtë vendim, caktohet juria profesionale për vlersimin e punimeve të busteve të dëshmorëve **Sadedin Hajda, Gëzim Hamza – Piktori dhe Mizair Isma**, në përbërje prej:
 1. Fehmi Hoxha, kryesues,
 2. Burim Durguti, anëtar,
 3. Besnik Hajda (familjar), anëtar,
 4. Fehmi Isma (familjar), anëtar,
 5. Luljeta Zllanoga (familjare), anëtare.
2. Juria profesionale ka për detyrë që të bëjë vlerësimin e punimeve të busteve të dëshmorëve: **Sadedin Hajda, Gëzim Hamza – Piktori dhe Mizair Isma**.
3. Obligohet juria profesionale që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.
4. Anëtarët e jurisë do të fillojnë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet t'i përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
5. Juria e caktuar profesionale, për punën e saj, do të hartojë një Raport me shkrim për kryetarin e Komunës.
6. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

U dërgohet :

1. Anëtarëve të jurisë,
2. Arkivit.

Smajl Latifi
për: 
Kryetar i Komunës



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLICA OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNES / KABINETI I PRESEDNIKA OPŠTINE / KABINETI I MUNICIPAL MAYOR

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2060 Nr. ifaq/Br. str./No. pg 8
Data/Datum/Date 29/8/23
RAHOVEC / ORAHOVAC



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna Rahovec
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 53 paragrafit 3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031, nenit 59 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, nenit 37 të Ligjit Nr. 05/L-068 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës Rahovec, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit me Nr. Prot.: 02/2033/23, i datës 23.8.2023, për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave

1. Me këtë vendim, ndryshohet dhe plotësohet vendimi me Nr. Prot. 02/2033/23, i datës 23.8.2023, për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave për projektin: "Ndërtimi i parqeve në Oterushë, Retijë e Poshtme, Dejnë dhe kolektorit për ujëra të zeza në Ratkoc dhe Rahovec", me Nr. prokurimi: 623-23-7507-5-2-1 dhe Nr. të brendshëm: 623-23-053-5-2-1, të datës: 22.8.2023.
2. Pika 1.1. e vendimit bazik ndryshohet dhe plotësohet, si në vijim:

1.1. Sokol Thaqi caktohet kryesues i komisionit.
3. Pikët e tjera të vendimit bazik, me Nr. Prot.: 02/2033/23, i datës 23.8.2023, mbesin të pandryshuara.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Me vendimin 02/2033/23, e datës 23.8.2023, është caktuar komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin "Ndërtimi i parqeve në Oterushë, Retijë e Poshtme, Dejnë dhe kolektorit për ujëra të zeza në Ratkoc dhe Rahovec", me Nr. prokurimi: 623-23-7507-5-2-1 dhe Nr. të brendshëm: 623-23-053-5-2-1, të datës: 22.8.2023.

Duke marrë parasysh se Jetmir Ukaj, i cili me vendimin bazik është caktuar kryesues i komisionit, gjendet në pushim vjetor, është i domosdoshëm zëvendësimi i tij dhe caktimi i Sokol Thaqit, kryesues i komisionit. Andaj, nga se u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- Sokol Thaqit,
- Zyrës së Prokurimit, dhe
- Arkivit.

 REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRESEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET	
Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)	
Nr./Br./No 2061 Nr. i faq./Br.str./No.pg 8	
Data/Datum/Data 29.8.23	
RAHOVEC / ORAHOVAC	

Smajl Latif
[Signature]
Kryetar i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna Rahovec
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.05/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 53, paragrafit 3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031, nenit 59 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, nenit 37 të Ligjit Nr. 05/L-068 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës Rahovec, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit me Nr. Prot. 02/1086/23, i datës 9.8.2023 për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave

1. Me këtë vendim, ndryshohet dhe plotësohet vendimi me Nr. Prot. 02/1086/23, i datës 9.8.2023, për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave për projektin: "Ndërtimi i punëve makinerike të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Rahovec", me Nr. prokurimi: 623-23-7193-5-2-1 dhe Nr. të brendshëm: 623-23-051-5-2-1, të datës: 3.8.2023.
2. Pika 1.1. e vendimit bazik, ndryshohet dhe plotësohet, si në vijim:

1.1. Sokol Thaqi caktohet kryesues i komisionit.
3. Pikët e tjera të vendimit bazik me Nr. Prot.: 02/1086/23, i datës 9.8.2023 mbesin të pandryshuara.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Me vendimin 02/1086/23, i datës 9.8.2023, është caktuar komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin "Ndërtimi i punëve makinerike të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Rahovec", me Nr. prokurimi: 623-23-7193-5-2-1 dhe Nr. të brendshëm: 623-23-051-5-2-1, të datës: 3.8.2023.

Duke marrë parasysh se Jetmir Ukaj, i cili me vendimin bazik është caktuar kryesues i komisionit, gjendet në pushim vjetor, është i domosdoshëm zëvendësimi i tij dhe caktimi i Sokol Thaqit, kryesues i komisionit. Andaj, nga se u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- Sokol Thaqit,
- Zyrës së Prokurimit, dhe
- Arkivit.

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRESEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 7062 Nr. i faq./Br.st./No.pg 8
Data/Datum/Date 29/8/23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Smajl Laçi
[Signature]
Kryetar i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.05/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 53, paragrafit 3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031, nenit 59 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, nenit 37 të Ligjit Nr. 05/L-068 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës Rahovec, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit me Nr. Prot. 02/2031/23, i datës 22.8.2023, për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave

1. Me këtë vendim, ndryshohet dhe plotësohet vendimi me Nr. Prot.: 02/2031/23, i datës 22.8.2023 për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave për projektin: "Investime dhe mirëmbajtja e hapësirave të gjelbëruara, parqet, varrezat në Komunën e Rahovecit", me Nr. prokurimi: 623-23-8000-5-2-1 dhe Nr. të brendshëm: 623-23-056-5-2-1, të datës: 21.8.2023.
2. Pika 1.1. e vendimit bazik ndryshohet dhe plotësohet, si në vijim:
1.1. Sokol Thaqi caktohet kryesues i komisionit.
3. Pikët e tjera të vendimit bazik, me Nr. Prot. 02/2031/23, i datës 22.8.2023, mbesin të pandryshuara.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e r i m

Me vendimin 02/2031/23, e datës 22.8.2023, është caktuar komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin "Investime dhe mirëmbajtja e hapësirave të gjelbëruara, parqet, varrezat në Komunën e Rahovecit", me Nr. prokurimi: 623-23-8000-5-2-1 dhe Nr. të brendshëm: 623-23-056-5-2-1, të datës: 21.8.2023.

Duke marrë parasysh se Jetmir Ukaj, i cili me vendimin bazik është caktuar kryesues i komisionit, gjendet në pushim vjetor, është i domosdoshëm zëvendësimi i tij dhe caktimi i Sokol Thaqit, kryesues i komisionit. Andaj, nga se u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- Sokol Thaqit,
- Zyrës së Prokurimit, dhe
- Arkivit.

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR'S CABINET
Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2663 Nr. i faq./Br.st./No.pg 9
Data/Datum/Data 24/8/23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Smail Latifi
(Signature)
Kryetar i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna Rahovec
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13, nenit 17 pika k) dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008"), nenit 12 pika 12.1, 12.4 dhe 12.5 të Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare dhe nenit 57, paragrafi 1, pika 1.11, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës Rahovec, Nr. 1005, të datës 29.3.2017, dhe kërkesës së z. Liridon Isakaj, me nr. prot.: 4077, të datës 10.8.2023, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **Miratohet** kërkesa e [redacted], Komuna Rahovec, me vendbanim në Rahovec, familja e të cilit përbëhet nga [redacted], për strehim të përkohshëm emergjent (vazhdimi i strehimit), si rast në nevojë sociale, në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, respektivisht nga data: 1.8.2023, deri më 31.1.2024, te pronari Naim Fazliu, në rrugën Xhelal Hajda -Toni pa nr., në Rahovec.
2. **Pagesa** në emër të qirasë do të jetë në shumën prej [redacted] për çdo muaj.
3. **Autorizohet** drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesjes Sociale në Komunën Rahovec që, sipas autorizimit ligjor, të lidhë marrëveshje për strehim të përkohshëm të familjes në nevojë sociale.
4. **Përfitues** nga pika 1 e këtij vendimi është [redacted].
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
6. **Vendimi** hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Drejtorja për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, pas pranimit të kërkesës nga pala, ka konstatuar se bëhet fjalë për familjen si kategori sociale me dy fëmijë të mitur, e që nuk kanë ku të strehohen, jetojnë me qira, ku të vetmin burim të të ardhurave i ka nga skema e ndihmave sociale, shumë e cila është e pamjaftueshme për t'i mbuluar të gjitha shpenzimet.

Mjetet për pagesë do të sigurohen nga kodi i shërbimeve sociale përmes DShMS-së, duke qenë se bëhet fjalë për rastin emergjent të strehimit të familjes, vendimi nuk është bazuar në procedurat ligjore që rregullojnë çështjet e prokurimit në Kosovë.

Andaj, nga se u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- [redacted]
- **Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,**
- **Arkivit.**

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINETI PRESIEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR'S CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2061 Nr. i faq./Br.st/No.pg 9
Data Dërgimi/Date 29/8/23
I. ORAHOVAC





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna Rahovec
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

Në mbështetje të nenit 13, nenit 17, pika k) dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008"), nenit 12, pika 12.1, 12.4 dhe 12.5 të Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare dhe nenit 57, paragrafi 1 pika 1.11, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës Rahovec, Nr. 1005, të datës 29.3.2017, dhe

prot.: 3067, të datës 24.7.2023, kryetari i Komunës, merr këtë:

VENDIM

1. [Redacted] në Kosovë, për strehim të përkohshëm emergjent (vazhdimi i strehimit), si rast në nevojë [Redacted] respektivisht nga data: 1.8.2023, deri më 31.1.2024, [Redacted]
2. Pagesa në emër të qirasë do të jetë në shumën prej 150.00€ (njëqind e pesëdhjetë euro) për çdo muaj.
3. Autorizohet drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesjes Sociale në Komunën Rahovec që, sipas autorizimit ligjor, të lidhë marrëveshje për strehim të përkohshëm të familjes në nevojë sociale.
4. Përfitues nga pika [Redacted]
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
6. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Arsyetim

Drejtorja për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, pas pranimit të kërkesës nga pala, ka pranuar kërkesën [Redacted] për ndihmë për strehim pasi nga shtëpia në të cilën ajo ka jetuar, me kërkesë të pronarit, është detyruar të largohet.

Drejtorja për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale ka dalë në vendin e ngjarjes dhe ka vizituar parashtruesen e kërkesës, me ç'rast ka konstatuar se është duke jetuar përkohësisht në një shtëpi në kushte të vështira, andaj, duke marrë parasysh [Redacted] e cila është duke jetuar në kushte të vështira ekonomike, dhe e ka të pamundur mbulimin e shpenzimeve për jetesë dhe pagesën e qirasë, është e domosdoshme ndihma për tejkalimin e kësaj gjendjeje.

Mjetet për pagesë do të sigurohen nga kodi i shërbimeve sociale përmes DShMS-së, duke qenë se bëhet fjalë për rastin emergjent të strehimit të familjes, vendimi nuk është bazuar në procedurat ligjore që rregullojnë çështjet e prokurimit në Kosovë.

Andaj, nga se u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,
- Të lartpërmendurës,
- Arkivit.

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA E KOSOVO / REPUBLIQUE DU KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNES / PRESEDNIK OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2065 Nr. i fuq./Br.sht./No.pg 2
Data/Datum/Data 29.8.23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës




Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna Rahovec

Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës Rahovec, Nr.1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës Rahovec, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, me titull: "Bartja e nxënësve sipas relacioneve për vitin shkollor 2023/2024 të Komunës së Rahovecit", me numër të kontratës 623-23-7197-2-2-1, si në vijim:
 - 1.1. Admirim Durguti, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës: zyrtar për paga dhe shpenzime, në Drejtorinë për Arsim, **CAKTOHET** menaxher i kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
 - 1.2. Avni Morina, drejtor i Drejtorisë për Arsim, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të datës 20.10.2022, si dhe Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhim të Kontratës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- Menaxheri i kontratës,
- Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,
- Sektori i Prokurimit,
- Drejtoria për Arsim, dhe
- Arkivi.

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës
Zyrtar Kryesor Administrativ

